2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Objekti i kontratës.

Objekti i kontratës është ofrimi i shërbimeve logjistike dhe organizative për zhvillimin e trajnimeve dhe seminareve për njësitë vendore, në bashki të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, për nevojat e autoritetit kontraktor.

Specifikimet teknike të këtij shërbimi janë hartuar për të garantuar ofrimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve trajnuese, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor dhe me parimet e konkurrencës së hapur, të paanshme dhe mosdiskriminuese.

Përshkrimi i përgjithshëm i shërbimit.

Operatori ekonomik duhet të ofrojë shërbime logjistike dhe organizative për realizimin e:

- 20 (njëzet) trajnimeve/seminareve;
- me kohëzgjatje 4 (katër) ditë për secilin trajnim/seminar, 6 (gjashtë) orë aktiviteti në ditë;
- gjithsej 80 (tetëdhjetë) ditë aktiviteti për një periudhë 12- mujore;
- me pjesëmarrje orientuese deri në 30 persona për çdo trajnim/seminar;

-
- me total orientues deri në 600 pjesëmarrës përgjatë zbatimit të kontratës.

Kjo kontratë nuk përfshin ofrimin e trajnerëve, hartimin e moduleve, përgatitjen e materialeve trajnuese apo përmbajtjen teknike të aktiviteteve.

Vendndodhja e realizimit të shërbimit.

Shërbimi do të ofrohet në të gjitha bashkitë e vendit, sipas planifikimit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të sigurojë shërbimin në vendndodhjet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, brenda afateve të njoftuara paraprakisht.

Përbërësit e shërbimit.

Shërbimi do të përfshijë, minimalisht, elementët e mëposhtëm:

- sigurimin e ambientit për zhvillimin e aktivitetit;
- organizimin dhe mbështetjen logjistike në vend;
- ofrimin e shërbimit të kateringut për çdo ditë aktiviteti.

Kërkesat teknike minimale për ambientin.

Për secilin trajnim/seminar, operatori ekonomik duhet të sigurojë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit, i cili duhet të plotësojë minimalisht këto kërkesa:

Kapaciteti dhe funksionaliteti

- Ambienti duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm deri në 30 pjesëmarrës, së bashku me stafin mbështetës dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor.
- Ambienti duhet të jetë i përshtatshëm për zhvillimin e një aktiviteti formal trajnues/seminari.
- Sallat duhet të jenë të mobiluara me tavolina dhe karrige në numër të mjaftueshëm dhe në gjendje të mirë përdorimi.

Kushtet fizike të ambientit.

- Ambienti duhet të jetë i pastër, i mirëmbajtur dhe funksional;
- Duhet të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe/ose artificial;
- Duhet të ketë ajrosje të përshtatshme;
- Duhet të ketë sistem ngrohje/ftohje funksional, sipas stinës dhe kushteve klimatike;
- Duhet të ketë ambiente sanitare funksionale dhe të mirëmbajtura;
- Duhet të ofrojë kushte të përshtatshme sigurie dhe akses normal për pjesëmarrësit;

Organizimi i sallës.

Organizimi i sallës duhet të mundësojë zhvillimin normal të aktivitetit, komunikimin ndërmjet pjesëmarrësve dhe realizimin e prezantimeve.

Sistemi i vendosjes së tavolinave dhe karrigeve do të përcaktohet sipas kërkesës së autoritetit kontraktor dhe natyrës së aktivitetit.

Kërkesat teknike minimale për mbështetjen logjistike dhe organizative.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë, për secilin aktivitet, mbështetje logjistike dhe organizative që përfshin minimalisht:

- koordinimin paraprak për rezervimin dhe vënien në dispozicion të ambientit;
- përgatitjen e ambientit përpara fillimit të aktivitetit;
- sistemin e sallës sipas kërkesave të autoritetit kontraktor;
- praninë ose disponueshmërinë e personelit mbështetës për zgjidhjen e nevojave logjistike gjatë zhvillimit të aktivitetit;
- garantimin e vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit;
- operatori ekonomik duhet të sigurojë që ambienti dhe të gjitha shërbimet përkatëse të jenë të gatshme për përdorim në orarin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Kërkesat teknike minimale për kateringun.

Për çdo ditë aktiviteti, operatori ekonomik duhet të sigurojë shërbim kateringun për pjesëmarrësit, stafin mbështetës dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor, sipas numrit të konfirmuar paraprakisht.

Shërbimi i kateringut duhet të përfshijë minimalisht:

- ujë për pjesëmarrësit;
- kafe dhe/ose pije të ngrohta;
- coffee break;
- drekë për çdo ditë aktiviteti.

Kërkesat cilësore për kateringun.

Produktet ushqimore duhet të jenë të freskëta, të sigurta për konsum dhe të servirura në kushte të përshtatshme higjieno-sanitare.

Operatori ekonomik duhet të respektojë legjislacionin në fuqi për sigurinë ushqimore, higjienën dhe shërbimet e ushqimit.

Shërbimi i kateringut duhet të ofrohet në kohën e përcaktuar në agjendën e aktivitetit.

Sasia e ushqimeve dhe pijeve duhet të jetë e mjaftueshme për numrin e pjesëmarrësve të konfirmuar.

Njoftimi dhe planifikimi i aktiviteteve.

Autoriteti kontraktor do të njoftojë operatorin ekonomik paraprakisht për:

- vendndodhjen e aktivitetit;
- datat e zhvillimit;
- numrin orientues të pjesëmarrësve;
- kërkesat e veçanta organizative, nëse ka.

Operatori ekonomik ka detyrimin të marrë masat e nevojshme për realizimin e plotë të shërbimit sipas njoftimit të bërë nga autoriteti kontraktor.

Kërkesa për realizimin e shërbimit në të gjithë periudhën kontraktore.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë kapacitetin organizativ dhe logjistik për realizimin e:

- 20 trajnimeve/seminareve;
- me kohëzgjatje 4 (katër) ditë secili me kohëzgjatje 6 (gjashtë) orë në ditë ;
- për një total prej 80 ditësh aktiviteti;
- gjatë një periudhe 12-mujore nga hyrja në fuqi e kontratës.

Kërkesa për cilësinë e shërbimit.

Shërbimi duhet të ofrohet:

- në kohë;
- në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor;
- me cilësi të përshtatshme organizative dhe funksionale;
- pa ndërprerje dhe pa mangësi që cenojnë zhvillimin normal të aktivitetit.

Në rast të mangësive në ambient, organizim apo katering, operatori ekonomik duhet të marrë masa të menjëhershme korrigjuese.

Dokumentimi dhe pranimi i shërbimit.

Për secilin aktivitet, shërbimi do të konsiderohet i realizuar pas:

- ofrimin të plotë të ambientit, mbështetjes logjistike dhe kateringut;
- verifikimit të realizimit nga autoriteti kontraktor;
- konfirmimit të pranimin të shërbimit sipas dokumentacionit përkatës.

Shënim i përgjithshëm.

Në hartimin dhe zbatimin e këtyre specifikimeve teknike, operatorët ekonomikë duhet të respektojnë legjislacionin në fuqi lidhur me:

- sigurinë dhe higjienën në ofrimin e shërbimeve;
- sigurinë ushqimore;
- standardet e shërbimit dhe të aksesit, sipas natyrës së kontratës.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: “Shërbime të trajnimit dhe seminareve për njësitë vendore”.

Afatet e ekzekutimit: Kohëzgjatja e kontratës është me afat të zbatimit të kontratës 12 (dymbëdhjetë) muaj.

- 20 (njëzet) trajnimeve/seminareve;
- me kohëzgjatje 4 (katër) ditë secili për 6 orë në ditë;
- me total 80 (tetëdhjetë) ditë aktiviteti;
- për një periudhë 12-mujore;
- me pjesëmarrje orientuese deri në 30 persona për aktivitet,

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është ofrimi i shërbimeve logjistike dhe organizative për zhvillimin e trajnimeve dhe seminareve për njësitë vendore, në funksion të forcimit të kapaciteteve të strukturave vendore në fushën e mbrojtjes civile.

Kontrata do të mbulojë organizimin dhe mbështetjen logjistike për 20 (njëzet) trajnime/seminare, të cilat do të zhvillohen në të gjitha bashkësi të vendit.

Qëllimi i kontratës.

Qëllimi i kësaj kontrate është sigurimi i kushteve të përshtatshme organizative dhe logjistike për zhvillimin e trajnimeve dhe seminareve me përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me nevojat e autoritetit kontraktor për rritjen e përgatitjes, koordinimit institucional dhe reagimit në fushën e mbrojtjes civile.

Baza dhe nevoja për shërbimin.

Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për mbrojtjen civile dhe për realizimin e veprimtarive trajnuese me strukturat e sistemit të mbrojtjes civile në nivel vendor, lind nevoja për kontraktimin e një operatori ekonomik që të sigurojë shërbimet logjistike dhe organizative për zhvillimin e këtyre aktivitetëve.

Nevoja për këtë kontratë konsiston në sigurimin e ambienteve të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetëve, si dhe në ofrimin e shërbimeve mbështetëse, përfshirë kateringun për pjesëmarrësit gjatë çdo dite aktiviteti.

Përshkrimi i përgjithshëm i shërbimit.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë, për secilin trajnim/seminar, shërbimet e mëposhtme:

- ambientin e përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit;
- mbështetjen logjistike dhe organizative për realizimin e aktivitetit;
- shërbimin e kateringut për pjesëmarrësit, stafin mbështetës dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor.

Kjo kontratë ka natyrë logjistike dhe organizative dhe nuk përfshin ofrimin e trajnerëve, hartimin e moduleve, përgatitjen e përmbajtjes teknike të trajnimeve apo zhvillimin e materialeve trajnuese.

Shtrirja dhe volumi i shërbimit.

Shërbimi do të realizohet për:

- 20 (njëzet) trajnime/seminare;
- me kohëzgjatje 4 (katër) ditë për secilin trajnim/seminar për 6 (gjashtë) orë në ditë;
- gjithsej 80 (tetëdhjetë) ditë aktiviteti gjatë periudhës së kontratës;
- me një numër orientues prej deri në 30 pjesëmarrës për çdo trajnim/seminar;
- me një total orientues prej deri në 600 pjesëmarrës përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Numri i pjesëmarrësve për secilin aktivitet është orientues dhe do të konfirmohet nga autoriteti kontraktor përpara zhvillimit të çdo trajnimi/seminari.

Vendndodhja e realizimit të shërbimit.

Trajnimet dhe seminarët do të zhvillohen në të gjitha bashkitë e vendit, sipas planifikimit dhe kërkesave të autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të jetë në gjendje të ofrojë shërbimin në ambiente të përshtatshme në gjitha bashkitë e vendit, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kërkesat minimale për ambientet.

Për secilin trajnim/seminar, operatori ekonomik duhet të sigurojë ambient të përshtatshëm për zhvillimin normal të aktivitetit, i cili duhet të plotësojë minimalisht këto kushte:

- të jetë i mobiluar dhe funksional;
- të ketë kapacitet të mjaftueshëm për numrin e pjesëmarrësve të njoftuar paraprakisht;
- të ketë ndriçim dhe ajrosje të përshtatshme;
- të ketë sistem ngrohje/ftohje sipas kushteve klimatike dhe sezonit;
- të ketë ambiente sanitare funksionale;
- të ofrojë kushte të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë trajnuese.

Autoriteti kontraktor mund të përcaktojë paraprakisht kërkesa shtesë lidhur me organizimin e sallës, në varësi të natyrës së aktivitetit.

Kërkesat për mbështetjen logjistike dhe organizative.

Operatori ekonomik duhet të sigurojë mbështetjen e nevojshme logjistike dhe organizative për secilin trajnim/seminar, përfshirë:

- koordinimin me vendin e zhvillimit të aktivitetit;
- përgatitjen dhe sistemin e ambientit përpara fillimit të aktivitetit;
- mbështetjen gjatë zhvillimit të aktivitetit për nevojat logjistike;
- garantimin e gatishmërisë për realizimin e aktivitetit sipas datës, vendit dhe kërkesave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Kërkesat për shërbimin e kateringut.

Për çdo ditë aktiviteti, operatori ekonomik duhet të sigurojë shërbim kateringut për pjesëmarrësit, stafin mbështetës dhe përfaqësuesit e autoritetit kontraktor, sipas numrit të pjesëmarrësve të konfirmuar paraprakisht.

Shërbimi i kateringut duhet të përfshijë minimalisht:

- ujë;
- kafe dhe/ose pije të ngrohta;
- coffee break;
- drekë për çdo ditë aktiviteti.

Shërbimi i ofruar duhet të jetë cilësor, i sigurt për konsum dhe në përputhje me standardet higjieno-sanitare në fuqi.

Afati i zbatimit të kontratës.

Afati i zbatimit të kontratës është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të saj.

Gjatë kësaj periudhe, operatori ekonomik do të realizojë shërbimet sipas kërkesave konkrete dhe njoftimeve paraprake të autoritetit kontraktor për secilin trajnim/seminar.

Detyrimet e operatorit ekonomik.

- të sigurojë ambientet dhe kushtet logjistike për zhvillimin e çdo aktiviteti;
- të ofrojë shërbimin e kateringut për çdo ditë aktiviteti;
- të garantojë cilësinë, pastërtinë, funksionalitetin dhe sigurinë e ambienteve;
- të bashkëpunojë me autoritetin kontraktor për planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve;
- të zbatojë në kohë kërkesat e njoftuara paraprakisht nga autoriteti kontraktor;
- të marrë masat e nevojshme për korrigjimin e menjëhershëm të çdo mangësie në ofrimin e shërbimit.

Detyrimet e autoritetit kontraktor.

Autoriteti kontraktor do të:

- përcaktojë temat dhe përmbajtjen e trajnimeve/seminareve;
- përcaktojë datën, vendndodhjen dhe agjendën e secilit aktivitet;
- njoftojë operatorin ekonomik paraprakisht për numrin orientues të pjesëmarrësve;
- monitorojë realizimin e shërbimit;
- konfirmojë pranimin e shërbimit pas realizimit të çdo aktiviteti.

Rezultatet e pritshme.

Në përfundim të zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të ketë marrë:

- organizimin logjistik dhe mbështetës për 20 trajnime/seminare;

-
- realizimin e tyre për një total prej 80 ditësh aktiviteti;
 - ambientet e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve në vendndodhjet e përcaktuara;
 - shërbim katering për çdo ditë aktiviteti, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor;
 - mbështetje organizative të nevojshme për zhvillimin normal të aktiviteteve.

1Mënyra e pranimi të shërbimit.

Shërbimi do të konsiderohet i realizuar pas përfundimit të çdo trajnimi/seminari dhe pas konfirmimit nga autoriteti kontraktor, mbi bazën e dokumentacionit përkatës të realizimit të shërbimit.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: sipas shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën përkatëse të vlefshme ISO 20121:2024 ose ekuivalente, të vlefshme në përputhje me objektin e prokurimit, për menaxhimin e qëndrueshëm të eventeve, me qëllim garantimin e standardeve për menaxhimin e ndikimeve mjedisore, sociale dhe ekonomike gjatë realizimit të shërbimit objekt prokurimi, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituar nga DPA ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 4 (katër) punonjës të punësuar, për koordinimin dhe realizimin e shërbimit, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë të paktën muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit të deklaruar, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se merr përsipër të kryejë shërbimin, sipas të gjitha kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

